# 30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVIZIONE



Fq. 2

## Platforma e Dialogut për Median, AMA ka përmbushur shumicën e rekomandimeve

## Konferenca Kombëtare "Gratë në qendër", Krasniqi: Tregu audioviziv dinamik, por i balancuar



Fq. 2

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X




Fq. 3

### Takimi i Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, AMA bashkëpunim të frytshëm me KiE

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në sesionin plenar të Konventës Kombëtare për

### Kryetarja e AMA-s kujton figurat e shquara të radios dhe ekranit ndër vite: "Mirënjohje për kontributin tuaj, keni qenë shkollë për ne"



Fq. 2




Fq. 3

### Monitorimi i përmbajtjeve në muajin nëntor, të parat renditen lajmet sociale pas tyre politika

Muaji nëntor ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Siç tregojnë të dhënat e përllogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në AMA...

## Platforma e Dialogut për Median, AMA ka përmbushur shumicën e rekomandimeve



Platforma e Dialogut për Median, një projekt i financuar nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës mblodhi së bashku drejtues të institucioneve dhe ekspertë të medias. Në këtë takim u diskutua mbi rekomandimet e dokumentit të prezantuar nga ekspertja, Znj. Tanja Kersevan, "Përshtatja e Peizazhit Mediatik të Shqipërisë me Standardet Europiane: Reformat Ligjore dhe Institucionale mbi Përqendrimin, Transparencën, Rregullimin e Medias dhe Median e Shërbimit Publik". Krasniqi u shpjegoi pjesëmarrësve se Autoriteti i Mediave Audiovizive ka kryer tashmë shumicën e detyrimeve të paraqitura në këtë dokument.
Lexo më shumë



## Konferenca Kombëtare "Gratë në qendër", Krasniqi: Tregu audioviziv dinamik, por i balancuar

"Tregu audioviziv ka shumë dinamizëm por është i balancuar". Kështu deklaroi kryetarja e AMA-s Znj. Armela Krasniqi në konferencën kombëtare me temë, "Gratë në qendër: Forcimi i medias me qasje përfshirëse në Shqipëri", organizuar nga SCiDEV dhe AWA, me mbështetjen e Bashkimit Europian. Në këtë konferencë u prezantuan gjetjet kryesore të dala nga zbatimi i projektit, "Thyejmë kallëpet, formësojmë të ardhmen", që synon transformimin e praktikave mediatike në Shqipëri, raportimin me perspektivë gjinore, rolin e grave në media, sigurinë e gazetarëve etj. Lexo më shumë



## Takimi i Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, AMA bashkëpunim të frytshëm me KiE

Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në takimin e III të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Në këtë takim Krasniqi theksoi se AMA dhe KiE po përgatisin një ndërhyrje tjetër të rëndësishme, e fokusuar te forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe trajtimit të ankesave brenda institucionit.
Lexo më shumë

## Kryetarja e AMA-s kujton figurat e shquara të radios dhe ekranit ndër vite: "Mirënjohje për kontributin tuaj, keni qenë shkollë për ne"



Fundi i vitit që shkoi u mbyll me një takim shumë të veçantë të kryetares së Autoritetit të Mediave me figurat e shquara të RTSH-së ndër vite. "Është privilegj për mua ta mbyll vitin e rrethuar nga personalitete si ju, me kontribute të jashtëzakonshme në media dhe jetën publike. Ju keni qenë shkollë për ne" – u shpreh Krasniqi duke i shprehur mirënjohjen veteranëve të RTSH-së.

Lexo më shumë




## Monitorimi i përmbajtjeve në muajin nëntor, të parat renditen lajmet sociale, pas tyre politika

Muaji nëntor ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Siç tregojnë të dhënat e përllogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në AMA pas sociales me 15.31%, vijnë lajmet politike me 13.76%. Vend të veçantë me 9.40%, ka zënë në mediat audiovizive lajmet e sportit, pasi gjatë muajit nëntor kombëtarja shqiptare pati dy ndeshje të rëndësishme me Anglinë dhe Andorrën.

Lexo më shumë